

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Avdi Dinaj, kryetar, Nesrin Lushta e Nebojša Boričić-anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit R. B. nga komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410.par.1.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.558/2016 të datës 07.07.2016., në seancën e mbajtur më 22.11.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit R. B. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.558/2016 të datës 07.07.2016.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.780/2015 të datës 03.02.2016. i dënuari R. B. është shpallur fajtor për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410.par.1.të KPK dhe është gjykuar me dënim me kusht me të cilin i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditëve i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale. Është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.558/2016 të datës 07.07.2016. është aprovuar ankesa e Prokurorit publik Themelor në Gjilan dhe aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, të dënuarit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpia prej datës 30.07.2015. deri më datën 13.08.2015.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë i dënuari ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të ndryshohet ashtu që të ngel në fuqi aktgjykimi i shkallës së parë ose dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë. Po ashtu ka propozuar që të ndalet ekzekutimi i dënimit deri në marrjen e vendimit sipas kësaj kërkesë.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.206/16 të datës 25.10.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoj se:

-kërkesa është e pabazuar.

Sipas pretendimeve në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë aktgjykimi i shkallës së dytë nuk është përpiluar sipas dispozitave ligjore për arsye se në dispozitivin e tij nuk ka përkrahje të fakteve dhe rrethanave të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale nga të cilat varet zbatimi i drejt i Kodit Penal. Po ashtu pretendohet se pasi që gjykata e shkallës së dytë e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë duke shqiptuar dënim me burgim efektiv në vend të dënimit me kusht, ka qenë e obliguar që të mbajti shqyrtim gjyqësor dhe në seancë të ftoj edhe të dënuarin dhe të mundësojë që i dënuari të sqarohet për zëvendësimin e këtij dënimi me dënim me gjobë.

Gjykata Supreme konstatoj se aktgjykimi i shkallës së dytë është përpiluar konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Në rastet kur gjykata e shkallës së dytë e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, pavarësisht se a ka shqiptuar dënim me të rënd, ligji nuk kërkon që në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë të jepet përshkrimi i veprimeve inkriminuese i të dënuarit dhe i fakteve nga të cilat varet aplikimi i Kodit Penal. Përshkrimi i tillë jepet në dispozitivin e aktgjykimin e shkallës së parë, siç parashihet me dispozitat e neneve 365.dhe 370.par.3.të KPPK.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes për ankesën e ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë nuk ka hapur shqyrtim por ka mbajtur seancë dhe konform dispozitës së nenit 390.par.1.të KPPK nuk ka pas obligim që për seancë te njoftojë të dënuarin sepse atij me aktgjykimin e shkallës së parë nuk i është shqiptuar dënim me burgim.

Më në fund, mundësia e zëvendësimit të dënimit me burgim deri në 6 muaj me dënim me gjobë, konform dispozitës së nenit 47.të KPK i është dhënë vetëm gjykatës së shkallës së parë ashtu që nuk mund të aprovohet as pretendimi se duke mos vepruar kështu gjykata e shkallës së dytë të dënuarit i ka pamundësuar mbrojtjen që i takon me ligj.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 270/2016, më 22.11.2016.

Proçesmbajtësja,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Avdi Dinaj